



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL

Nr. 3, datë 12.06.2026

**I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës që zhvillohet në sallën e Këshillit
Bashkiak**

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:25

Data e mbajtjes së mbledhjes : 12.06.2026

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Kryetarja e Bashkisë znj. Emiriana Sako si dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Denisa Luarasi: Të nderuar këshilltarë !E nderuar kryetare e bashkisë !

Të nderuar të pranishëm, media!

Deklaroj të hapur këtë mbledhje të radhës për Këshillin Bashkiak Durrës.

Në këtë mbledhje do të shqyrtojmë dhe do të miratojmë 13 projektvendime të propozuara nga kryetarja e bashkisë. Materialet ju janë vënë në dispozicion nga Sekretariati i Këshillit. Ftoj sekretaren të procedojë me thirrjen e emrave.

Dorina Milja: Përshëndetje! Na falni për vonesën !

Fillojmë...

Ardian Mukaderi tek.... Florian Tahiri...

39 këshilltarë në sallë.

V.O Hyn me vonesë në sallë këshilltarja Zhuljeta Ngota. Gjithsej 40 këshilltarë në prezencë.

Denisa Luarasi: Faleminderit Dori.

Meqë kuorumi është i pranishëm, vazhdojmë me mbledhjen. Po lexoj pikat e rendit të ditës.

Pika 1.	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË DURRËS, PËR MUAJIN PRILL 2026
Pika 2.	PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 4010444 (KATËR MILIONË E DHJETË MIJË E KATËRQIND E DYZET E KATËR) LEKË TË PARAFINANCUARA NGA PROJEKTI SUSTAINABLE MOBILITY UPGRADE - SUMO 2.0, PROGRAMI INTERREG IPA SOUTH ADRIATIC (2021-2027)
Pika 3.	PËR MIRATIMIN E EMËRTIMIT TË RRUGËS “ARTUR BUJARI” ME VENDNDODHJE: NJËSIA ADMINISTRATIVE RRASHBULL, BASHKIA DURRËS
Pika 4.	PËR MIRATIMIN E RAPORTIT MBI MONITORIMIN E ZBATIMIT TË BUXHETIT TË BASHKISË DURRËS PËR VITIN 2025
Pika 5.	PËR MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM VENDOR 2027-2029 TË BASHKISË DURRËS
Pika 6.	PËR MIRATIMIN E NGRITJES DHE FUNKSIONIMIT TË “QENDRËS PËR SHËRBIME MBËSHTETËSE PËR FËMIJËN DHE FAMILJEN” ME MBËSHTETJEN NGA PROGRAMI I FONDIT SOCIAL TË BUXHETIT TË SHTETIT PËR VITET 2026-2028 DHE BUXHETI I BASHKISË DURRËS
Pika 7.	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË DURRËS, PËR MUAJIN MAJ 2026
Pika 8.	PËR MIRATIMIN E NDIHMËS FINANCIARE ME VLERË 2,845,208 LEKË, PËR FAMILJET QË KANË PËSUAR DËME SI PASOJË E RËNIES SË ZJARRIT NË BANESAT E TYRE"
Pika 9.	PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE MENAXHIMIN E ZJARREVE NË PYJE DHE KULLOTA TË BASHKISË DURRËS PËR VITIN 2026
Pika 10.	PËR MIRATIMIN PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT PËR NËNSHKRIMIN E AKTMARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET SIPËRMARRËSIT “DULE” SHPK DHE PËRFITUESIT BASHKIA DURRËS, PËR RIKONSTRUKSIONIN E QENDRËS SHËNDETËSORE PORTO ROMANO, NJËSIA NR.4, BASHKIA DURRËS
Pika 11.	PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDEVE TË TRASHËGUARA NGA VITI 2025
Pika 12.	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË OBJEKTET: 1. PALLATI NR. 7, RRUGA “BASHKIMI”, NJËSIA ADMINISTRATIVE MANËZ 2. PALLATI NR. 5, RRUGA “BASHKIMI”, NJËSIA ADMINISTRATIVE MANËZ, 3. PALLATI NR. 32, RRUGA “TEODOR RUPI”, NJËSIA ADMINISTRATIVE NR.3, 4. PALLATI NR. 15, RRUGA “5 PRILLI”, NJËSIA ADMINISTRATIVE ISHËM 5. PALLATI NR. 8, RRUGA “STEFAN DHIMA”, NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 3

	6. PALLATI NR.25/1, RRUGA “HYSEN MYSHKETA”, NJËSIA ADMINISTRATIVE NR.3 7. PALLATI NR. 32, RRUGA “HYSEN KERTUSHA”, NJËSIA ADMINISTRATIVE NR.3 8. PALLATI NR. 53, RRUGA “KRISTO SOTIRI”, NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 4 9. PALLATI NR.122, RRUGA “ALEKSANDËR GOGA”, NJËSIA ADMINISTRATIVE NR.4 10. PALLATI NR. 18, RRUGA “DAVID SELENICA”, NJËSIA ADMINISTRATIVE NR.5 11. PALLATI NR. 10, RRUGA “SHEFKI ELEZI”, NJËSIA ADMINISTRATIVE SUKTH 12. PALLATI NR. 121, RRUGA “VADARDHË KULLË”, NJËSIA ADMINISTRATIVE SUKTH 13. PALLATI NR. 6, RRUGA “AHMET ADEMI”, NJËSIA ADMINISTRATIVE SUKTH 14. PALLATI NR. 98, RRUGA “HAMALLAJ”, NJËSIA ADMINISTRATIVE SUKTH 15. SHTËPI INDIVIDUALE, NJËSIA ADMINISTRATIVE NR.1 16. SHTËPI INDIVIDUALE, NJËSIA ADMINISTRATIVE NR.2 17. KABINAT E PLAZHIT TË NDODHURA NË LAGJEN NR.13, RRUGA “ABDULLAH TABAKU”, NJËSIA ADMINISTRATIVE NR.5 18. SHTËPI INDIVIDUALE, NJËSIA ADMINSITRATIVE MANËZ 19. SHTËPI INDIVIDUALE, NJËSIA ADMINSITRATIVE KATUND I RI 20. SHTËPI INDIVIDUALE, NJËSIA ADMINISTRATIVE SUKTH
Pika 13.	PËR MIRATIMIN E HARTËS SË VENDQËNDRIMEVE TË MJETEVE LUNDRUESE DHE KORRIDOREVE TË LËVIZJES SË TYRE NË TERRITORIN E BASHKISË DURREËS

Keni ndonjë koment?

Jeni dakort me rendin e ditës?

Ardian Muka: Po, kam..

Denisa Luarasi: Po, Muka.

Ardian Muka: Mirëdita të gjithëve. Një koment thjesht për procedurë.

Nga mbledhja e kryesisë së kryetarëve, faktikisht e thashë, unë e kam marrë emërimin më pak dhe sugjerova që të mos bëhet online.

Denisa Luarasi: Urime për detyrën e re.

Ardian Muka: Faleminderit.

Të mos bëhet online, meqenëse ne mund të kemi për të diskutuar edhe problematika që pastaj duam t’ia përcjellim grupit. Mundësisht të bëhet me prezencë.

Denisa Luarasi: Patjetër.

Ardian Muka: Një propozim që bëra për sa i takon anës formale të paraqitjes së dokumentit. Atëherë, për listimin e problematikave do të preferoja të shkonin të grupuara, pra pjesa ekonomike, pjesa sociale, pjesa urbane, pjesë të ndryshme. Këtu kemi çështjen 4, 5, 11, që kanë lidhje me probleme ekonomike. Diskutojmë për 4, 5, pastaj spostohet vëmendja dhe dalim te 11. Mundësisht të jenë të grupuara. Këto kisha.

Denisa Luarasi: Faleminderit, shumë faleminderit.

Koment tjetër ka? Nuk ka. Kalojmë në votim elektronik.

Me 39 vota pro miratohet rendi i ditës.

- I jepet fjala për projekt-vendimin **e pikës 1**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë, përshëndetje të gjithëve.

Komisioni ynë e miratoi pikën e parë dhe fton Këshillin të japë votën pro. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Musaraj.

E merr fjalën Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqenies Sociale dhe Mosdiskriminimit, znj. Edlira Shemsi.

Denisa Luarasi: Ju lutem, thërrite mikrofonin.

Jo, ndoshta 5-ën.

Mamo, mund ta ndihmosh pak? Ok, vazhdojmë.

Edlira Shemsi: Tashi u ndez.

Komisioni i Barazisë Gjinore, Çështjeve Sociale dhe kundër Diskriminimit, pasi shqyrtoi listën e familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% dhe nga fondi i të ardhurave të Bashkisë për muajin Prill 2026, e miratoi atë dhe ia propozon Këshillit për miratim.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit, zonja Shemsi.

Komente, pyetje kemi për pikën 1 të rendit të ditës?

Nuk ka. Kalojmë në votim.

Me 39 vota pro miratohet pa ndryshime edhe pika 1 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projekt-vendimin **e pikës 2**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë, edhe për pikën e dytë ne me shumicë votash e miratuam këtë dhe ftojme Këshillin të japë votën pro. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Musaraj.

E merr fjalën Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave, z. Rolant Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj: Përshëndetje.

Edhe komisioni jonë me shumicë votash e kalon këtë pikë për miratim në mbledhjen e Këshillit.

Denisa Luarasi: Faleminderit, z. Xhelilaj.

Komente, pyetje ka për pikën 2 të rendit të ditës?.....

Nuk ka. Kalojmë në votim....

Ok, Muka.

Ardian Muka: Flitet për miratimin e përdorimit të fondit prej 4.010.440 lekësh të parafinancuar nga projekti sustainable mobility. Kur themi të parafinancuar, çfarë kemi parasysh? Ku janë parafinancuar, pra çfarë kemi bërë gjatë kësaj kohe? Faleminderit!

Denisa Luarasi: Faleminderit.

Ndonjë nga administrata do ta shpjegojë pyetjen e Mukës?

Floreta Kërtusha (*Përgjegjëse pranë Drejtorisë së Turizmit*): Atëherë, programet e Bashkimit European...

Denisa Luarasi: Mund të prezantohesh?

Floreta Kërtusha: Po, ndjesë. Floreta Kërtusha, përgjegjëse e Njesisë së Integritimit European dhe Ndihmës së Huaj në Drejtorinë e Turizmit.

Faleminderit dhe për interesimin edhe për Komisionin e Integritimit European. Në fakt, rregullorja e BE-së, ose më saktë e programit IPA South Adriatic, parashikon që për çdo projekt, në mënyrë që të zbatohen aktivitetet në fillim të projektit, shuma e parafinancimit është 20%, për programet e Bashkimit European. Kështu që është fondi i ardhur nga Bashkimi European.

Ardian Muka: Pra, financimin e ka bërë Bashkia?

Floreta Kërtusha: Jo, jo. Nga fondet e Bashkimit European, nga programi IPA South Adriatic. Është kushti që, në mënyrë që Bashkia të avancojë me zbatimin e projektit, Bashkimi European parashikon një parafinancim me shumën 20%. Ka programe që e kanë 10%, ka programe që e kanë 20%. Ky është fond i ardhur nga Bashkimi European, jo nga Bashkia.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit.

Floreta Kërtusha: Por për të përdorur fondet, meqenëse çdo shpenzim kalon tashmë nëpërmjet Degës së Thesarit dhe jo bankës së nivelit të dytë, sipas udhëzimit të Ministrit të Financave, çdo fond i ardhur nga Bashkimi European duhet të kalojë për procedurë, sepse këtë gjë do ta bëjmë shpesh në vazhdimësi tani. Çdo e ardhur nga Bashkimi European do të kalojë si përdorim fondi në Këshillin Bashkiak.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit, znj. Kërtusha.

Kalojmë në votim. Kush është pro?

Me 40 vota pro miratohet edhe pika 2 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projekt-vendimin **e pikës 3** Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë, edhe pikën 3 ne e votuam pro dhe ftojmë Këshillin ta miratojë sot. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit, zonja Musaraj.

E merr fjalën Komisioni i Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit, z. Kastriot Xhongoli.

Kastriot Xhongoli: Përshëndetje.

Edhe komisioni ynë ra dakord që kjo pikë të kalojë në Këshillin Bashkiak.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit, z. Xhongoli.

Komente, pyetje ka për pikën 3 të rendit të ditës?

Nuk ka. Kalojmë në votim elektronik.

Me 40 vota pro miratohet edhe pika 3 e rendit të ditës.

- Kalojmë te **pika 4**. I jepet fjala Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë, edhe pikën 4 ne e votuam pro dhe ftojmë Këshillin ta miratojë sot. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit.

Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave, z. Rolant Xhelilaj.

Flori, ndihmoje pak. Po.

Rolant Xhelilaj: Edhe Komisioni i Ekonomisë dhe Buxhetit e kalon këtë pikë për miratim të Këshillit Bashkiak.

Denisa Luarasi: Faleminderit, z. Xhelilaj.

Pyetje, komente kemi për pikën 4 të rendit të ditës?

Po, Muka.

Mikrofonin, ju lutem, Muka.

Jo.... Mund të përdorësh një mikrofon tjetër që të mos vonohemi?

Shtype 5-ën. Ok

Ardian Muka: Atëherë, pyetja e parë që kisha, dhe pastaj kam një koment.

Do të doja të dija, “Raporti mbi monitorimin e zbatimit të buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2025”, nga është përpiluar ky raport? Sepse nuk na thuhet nëse është raport i Bashkisë apo është një ent i jashtëm i pavarur. Mund të kem një përgjigje?

Denisa Luarasi: Ok, faleminderit.

Kush do të përgjigjet nga administrata?

Valbona Qirjako: Unë jam Valbona Qirjako, drejtore e Drejtorisë së Buxhetit. Ky raport është hartuar nga grupi i menaxhimit strategjik, siç e shikoni në material dhe në projekt-vendim, ku çdo drejtor ka vënë firmën, që tregon se është përgjegjës për materialin e përgatitur. Çdo drejtori përgatit pjesën e vet dhe pastaj është Drejtoria e Buxhetit është ajo që bën bashkimin, por edhe e harton këtë projekt-raport në përputhje me ligjin për financat e vetëqeverisjes vendore.

Ardian Muka: Është material i përgatitur nga ana e stafit të Bashkisë?
Nuk është audit i jashtëm apo?

Valbona Qirjako: Po, nga ana e stafit të Bashkisë. Jo, jo, nuk është. Është detyrim ligjor sipas ligjit të financave vendore që e përgatit Bashkia. Nuk është audit i jashtëm, siç mund të jetë KLSH apo ndonjë organizatë.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit.
Pyetje tjetër ka? Po.

Ardian Muka: Atëherë, në pjesën e vështrimit të përgjithshëm do të përpiqem të jem sa më konçiz.

Denisa Luarasi: Duke respektuar minutazhin.

Ardian Muka: Patjetër, por do të flas edhe në emër të grupit, kështu që...
Bashkia e Durrësit për vitin 2025 vlerën fillestare të buxhetit e ka pasur 5 milion e 449 mijë në vazhdim lekë dhe në vazhdim këtu ka shtesa për sa i takon fondit të trashëguar për vitin 2024, për vlerën 1 miliard e 44 milionë dhe pjesa tjetër bishta. Sikurse ka edhe burime qendrore në formë të transfertës së kryqëzuar sektoriale për vlerën 55 milionë, pjesa tjetër, si dhe granti i huaj për 1 milion e 58 mijë lekë. Pra, buxheti i Bashkisë për vitin 2025, pa fondin e rindërtimit dhe fondin e ministrive, është 6 miliardë e 556 milionë lekë, të përkthyer në lekë të vjetra 65 miliardë lekë. Duke pasur parasysh që edhe shtesa e fondeve të rindërtimit, buxheti total i Durrësit për vitin 2025 kap vlerën e 10 miliardë e 300 milionë lekëve dhe, duke pasur parasysh edhe transfertat e tjera sektoriale, transfertat e kushtëzuara dhe të gjitha, totali i Bashkisë për vitin 2025 rezulton 10 miliardë e 621 milionë e 116 mijë lekë. Kjo në vlerë, e përkthyer në euro që ta kuptojmë, me kursin ditor, është rreth 110 milionë euro buxheti total i Bashkisë. Sipas këtij raporti kemi një rritje krahasuar me vitin 2024 me 12% dhe kjo rritje vjen kryesisht si rezultat i rritjes së të ardhurave nga burimet e veta dhe nga taksat e ndara, të cilat rezultojnë 75% më shumë se viti 2024. Kjo është çka na referohet në raport. Ndërkohë që, raporti jep që ne kemi për vitin 2025 një mosrealizim me 30 miliardë e diçka, e përkthyer në euro rreth 32 milionë euro. Kemi një mosrealizim të këtyre shpenzimeve. Pra, ne kemi një fond prej 110 milionësh, ndërkohë që 32 milionë nuk kemi arritur t'i shpenzojmë si Bashki. Kjo është çfarë raporti na jep deri në fund dhe këtë pastaj ne do ta shohim në pikën 4 dhe në pikën 11, ku janë kërkesat që nga ana e Bashkisë i drejtohen Këshillit për rialokim të fondeve, të cilat i kemi të mbartura nga viti 2025 për vitin 2026.

Ajo që unë do të thoja është që qyteti ka nevojë për investime. Ne këtë e dimë të gjithë. Kemi shumë problematika, duke filluar nga kanalizimet. Kemi parë që sa herë bie shi kemi probleme me përmbytjet. Kemi rrugë të reja në zonat, si në zonat kodrinore ashtu edhe në zonën e Durrësit të Ri, që kanë ngritur shqetësime të përhershme për mungesën e infrastrukturës, po ashtu edhe për gjithë pjesën e komunave, të cilat na paraqesin kërkesa për zhvillime në aspektin urban.

Kemi kërkesë nga banorët e TID. I kemi aty në protestë poshtë. Në qoftë se këto 32 milionë euro ne i kemi si mundësi, dhe ne e kemi ngritur disa herë këtë shqetësim, pse të mos ua japim një pjesë këtyre për të përmbushur atë çka janë kërkesat e tyre dhe ne të çojmë përpara projektin TID, për të cilin e kemi thënë që jemi për zhvillimin e këtij projekti, sepse do të jetë një vlerë e shtuar për qytetin, natyrisht duke bërë ato ndryshime që ata banorë dhe ato sugjerime që ne kemi shprehur, si edhe specialistët e fushës.

Kemi problemin e trajtimit të mbetjeve. Qyteti sot e kësaj dite e ka zërin kryesor në buxhet, sepse ne i marrim mbetjet, nuk i trajtojmë në Durrës, por i çojmë në Landfillin e Sharrës. Pse me këto 32 milionë euro që ne i kemi të paplotësuara nga 2025 të mos krijojmë një infrastrukturë për qytetin, që ne të fillojmë t'i trajtojmë mbetjet në qytetin e Durrësit, mundësisht nëpërmjet riciklimit, që kjo mos të jetë një barrë për buxhetin e qytetit, por të jetë një vlerë e shtuar.

Për ta përmbyllur, fakti që ne nuk arrijmë të kryejmë investime me ato para që i kemi mbledhur nëpërmjet taksave dhe tarifave, si dhe fondeve që na vijnë nga ana e qeverisë nëpërmjet kanaleve të ndryshme të financimeve që ne marrim si Bashki, tregon për një moseficientë nga ana e Bashkisë. 30% e këtij buxheti nuk ka arritur të realizohet. Një moseficientë, një keqorganizim në programim dhe në vizionin e Bashkisë.

Faleminderit.

Denisa Luarasi: Ok, faleminderit.

Po Markola.

Hekuran Markola: Faleminderit.

Se zoti Muka flet për moseficientë, por faktikisht buxheti ose realizimi i planit 2025, është 112% realizim nga planifikimi që është bërë në realitet dhe kjo nuk mund të quhet një moseficientë, por një eficientë e jashtëzakonshme, sepse ne, në historikun tonë të Bashkisë, jemi mësuar që planet që bëjmë në fund të vitit për vitin pasardhës zakonisht shkojnë tek 80-90%, nuk realizohen asnjëherë. Dhe duke e krahasuar me vitin 2024, nuk e di ku i merr të dhënat, por të ardhurat nga taksat, nga të ardhurat e veta që i ka Bashkia, nuk janë rritur me 70%, por mund të themi 140% është rritja, ose krahasuar me vitin 2024, të ardhurat e vitit 2025 janë rritur me 240%, të ardhurat e veta, dhe ky është një sukses i jashtëzakonshëm i Bashkisë për vitin 2025 dhe urojmë të vazhdojë kështu dhe viti tjetër të mbyllet i tillë. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit, Markola.

Po Kasa.

Flutura Kasa: Përshëndetje.

Kisha vetëm një pyetje për zotin Muka. Te rregullorja e Këshillit Bashkiak, ku janë edhe të drejtat e këshilltarëve, përpara se të vijmë këtu në Këshill ka disa dyer, Bashkia ka disa drejtori ku ne mund të kërkojmë shpjegime. Nëse ato dyer nuk na hapen për të marrë shpjegimet e nevojshme,

atëherë ne me të drejtë i kërkojmë gjërat në Këshill. Sepse unë them që kur kërkon diçka në Këshill, nuk është se ti e merr zgjidhjen aty në moment, ndërsa kur shkon në drejtorinë përkatëse dhe ulesh këmbëkryq me këta drejtorë të Bashkisë, them që zgjidhja do të jetë më efikase dhe nuk është shumë e nevojshme të diskutohet. Por unë, mesa shoh, shumë rrallë këshilltarët e opozitës i shohin dyert e Bashkisë, përveç ditës që kanë mbledhjen e Këshillit, sepse në momentin që ne jemi votuar, jemi votuar me ardhë me shqetësuar administratën e Bashkisë dhe jo vetëm me fol për mbledhjen e Këshillit Bashkiak. Unë bëj pyetje në Këshillin Bashkiak, por bëj kur nuk gjej zgjidhje në drejtorinë përkatëse. Kaq kisha.

Denisa Luarasi: Për replikë.

Ardian Muka: Për t'ju përgjigjur, zonja Kasa, nuk kam.

Për sa i takon drejtorive, ne kemi raportin dhe ne nga raporti po gjejmë në bazë të raportit. Ndaj e pyeta edhe drejtoreshën, e cila dha një përgjigje që ky është një raport i ndërtuar nga ana e administratës së Bashkisë. Natyrisht, problematikat që kemi i kemi ngritur edhe pranë drejtorive përkatëse, por në këtë rast kërkesa dhe shqetësimi jonë kishte lidhje me këtë problematikë që ngremë. Meqenëse kemi realizuar të ardhura, duke iu përgjigjur edhe z. Markola me 240 e ca %, por nuk kemi arritur që të realizojmë 30% të asaj që kemi për fonde, nuk kemi arritur që t'i japim të mira, t'i përkthejmë në investime për qytetin.

Denisa Luarasi: Faleminderit.

Po Konesha, ju lutem përqendrohu.

Munir Konesha: Tani unë do e nis nga zoti Muka që në lidhje me pyetjen...

Denisa Luarasi: Të lutem jo me emra, se do zgjatem me replika.

Munir Konesha: Tani unë kështu di me diskutuar.

Denisa Luarasi: Ok, e përmende tani. Pak më me kujdes.

Munir Konesha: Jo, e nisi për raportin. Ky raport i vjen Këshillit në mënyrë periodike, nuk është hera e parë. Në lidhje me mosrealizimin e shpenzimeve mund të ketë edhe faktor subjektiv të Bashkisë, por unë doja t'i kujtoja opozitës se viti 2025 ka qenë vit elektoral dhe në Shqipëri jemi të gjithë të pranishëm që në vitin elektoral nuk lejohet të kryhen shpenzime, prokurime. Besoj që ky ka qenë një nga ndikimet dhe do të jetë ndikim i vazhdueshëm në realizimin e shpenzimeve në vitet elektorale.

Po kështu, unë dua të përgëzoj administratën në lidhje me të ardhurat. Duhet ta pranojmë ne se të ardhurat janë realizuar në ato shifra, por është një faktor i veçantë, siç është taksat e infrastrukturës. Por tatimet që vjel Bashkia dhe tarifatat, kryesisht nga familjarët, janë tejkaluar dhe po vijnë të realizuara në mënyrë të vazhdueshme ka pothuajse 3 vjet.

Por kujdes duhet të bëjë Bashkia, se ka problematikë me të ardhurat lidhur me bizneset. Të ardhurat lokale nga bizneset janë në shifrat e planit, mund të ketë, por... Këto kam unë në lidhje me mosrealizimet. Unë besoj se faktori kryesor ka qenë viti elektoral.

Denisa Luarasi: Faleminderit, Konesha.

Po Muka për replikë.

Ardian Muka: Me këtë logjikë i bie që ne çdo 2 vite nuk do realizojmë planin e investimeve, sepse kemi vite elektorale. Bashkia e di që hyn në një vit elektoral, prandaj duhet të marrë të gjitha masat që, si përsa i përket prokurimeve, si përsa i përket garave, si përsa i përket fondeve, duhet t'i kryejë brenda periudhës nga e cila Këshilli Bashkiak ka kryer aprovimet. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit shumë, i qartë.

Atëherë kalojmë në votim.

Kush është pro?

Meqenëse Bledari është larguar, me 35 vota pro, 2 abstenim dhe 2 kundër, miratohet edhe pika 4 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projekt-vendimin **e pikës 5**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë, edhe pikën 5 ne si komision i dhamë votën pro dhe ftojme Këshillin ta miratojë sot. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Musaraj.

Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave, z. Rolant Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj: Edhe komisioni jonë e kalon për miratim në mbledhjen e Këshillit, unanimisht.

Denisa Luarasi: Faleminderit, z. Xhelilaj.

Komente, pyetje ka për pikën 5 të rendit të ditës?

Po Muka.

Thërrite mikrofonin.

Ardian Muka: Përsa i takon pikës 5, miratimin e tavaneve përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2027-2029 të Bashkisë Durrës e shoh si një apendiks, si një dokument të pavlefshëm, përderisa të caktojmë ne tavane, përderisa Bashkia aprovon buxhetin, bën rishikim të buxhetit në periudha të ndërmjetme, bën ristrukturime të buxhetit, bën rialokime, siç po kërkojmë të bëjmë tani për fonde që kemi nga 2025 për 2026. Më duket se miratimi i tavaneve më duket si një shtesë, një apendiks i panevojshëm, i palogjikshëm deri në një farë pike për të kaluar në Këshillin Bashkiak. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit, z. Muka.

Atëherë kalojmë në votim. Kush është pro?

Atëherë, me 27 vota pro, 2 abstenim dhe 9 kundër, miratohet pa ndryshime pika 5 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projekt-vendimin **e pikës 6**, fjala Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë, edhe këtë pikë e miratuam dhe Këshillit i kërkojmë sot të japë votën pro. Faleminderit

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Musaraj.

E merr fjalën Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave, z. Rolant Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj: Komisioni ynë unanimisht e miraton pikën 6 dhe e kalon në Këshill për miratim, për votim.

Denisa Luarasi: Faleminderit, z. Xhelilaj.

Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqenies Sociale dhe Mosdiskriminimit, znj. Edlira Shemsi.

Ju lutem, tërhiqni mikrofonin se nuk incizohesh.

Edlira Shemsi: Komisioni i Çështjeve Sociale, Barazisë Gjinore dhe Kundër Diskriminimit, pasi mori në shqyrtim listën e familjeve që marrin ndihmë ekonomike për muajin maj 2026, e miratoi atë dhe ia kalon këshillit për votim.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit, zonja Shemsi.

Komente, pyetje ka për pikën 6 të rendit të ditës?

Nuk ka. Kalojmë në votim.

Me 38 vota pro, miratohet edhe pika 6 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projekt-vendimin (dikush ka thërritur: rregulloni mikrofonin). I jepet fjala për projekt-vendimin **e pikës 7**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë, edhe pikën 7 e votuam pro dhe i kërkojmë këshillit ta miratojë sot. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Musaraj.

Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqenies Sociale dhe Mosdiskriminimit, Edlira Shemsi.

Ju lutem mikrofonin, edhe njëherë, të lutem, edhe njëherë, nuk incizohet.

Edlira Shemsi: Edhe komisioni ynë, pasi e shqyrtoi, me shumicë votash e miratoi këtë pikë dhe ia referon Këshillit për votim.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit.

Komente, pyetje ka për pikën 7?.....

Kalojmë në votim.

Me 38 vota pro, miratohet edhe pika 7 e rendit të ditës.

- Jepet fjala për projekt-vendimin **e pikës 8**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë, edhe pikën 8 e votuam pro dhe ftojme Këshillin ta miratojë sot.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Musaraj.

Komisioni i Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë, zonja Mirela Shala.

Mirela Shala: Përshëndetje.

Komisioni i Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë e shqyrtoi dhe e miratoi me shumicë votash dhe e kalon për votim në Këshillin Bashkiak.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Shala.

Komente, pyetje ka për pikën 8 të rendit të ditës?

Nuk ka. Kalojmë në votim.

Me 38 vota pro, miratohet edhe pika 8 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projekt-vendimin e **pikës 9**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Edhe pikën 9 e votuam pro dhe ftojme Këshillin që ta miratojë sot. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Musaraj.

Komisioni i Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë, zonja Mirela Shala.

Edhe njëherë.....

Mirela Shala: Edhe komisioni e miratoi me shumicë votash dhe e kaloi për votim këtë pikë.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Shala.

Kemi komente, pyetje?Ka?

Nuk ka. Kalojmë në votim?

Me 38 vota pro, miratohet pika 9 e rendit të ditës pa ndryshime.

- I jepet fjala për projekt-vendimin **nr. 10**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Edhe pikën 10 e votuam pro dhe ftojme Këshillin që ta miratojë sot. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Musaraj.

Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor, zoti Hekuran Markola.

Hekuran Markola: Faleminderit.

Komisioni i Pronave Publike e kaloi me unanimitet për votim në Këshillin Bashkiak.

Madje, zoti Muka shprehu: A ka hapësira t'i japë një dekoratë kompanisë “Dule” shpk për këtë rast?

Denisa Luarasi: Faleminderit.

Po, Muka.

Ardian Muka: Në komision diskutuam, meqenëse kjo kompani, kompania Dule, kompani private, është rasti i tretë që kryen një investim nëpër qendra shëndetësore, kryesisht nëpër komuna, me të drejtë unë ia thashë edhe kryetarit, e cila kësaj kompanie, që vjen dhe kryen këtë lloj ndihme ndaj komunitetit, pse jo nga ana e bashkisë të shihet mundësia që t'i jepet, jo dekoratë, por t'i jepet një mirënjohje. Pastaj mirënjohja...

Markola ka ngel te dekoratat.

Faleminderit.

Denisa Luarasi: Komente të tjera kemi?

Flutura Kasa: Markolës doja t'i thoja, fol me mikrofon se bën ca pyetje të bukura që s'duhet të na ikin. Jo, jo, por nuk e dëgjova këtë punën e dekoratës.

Denisa Luarasi: Ok, faleminderit.

Është mirë kur ka dhe kështu momente gazmore.

Atëherë kalojmë në votim për pikën 10 të rendit të ditës.

Me 38 vota pro, miratohet edhe pika 10 e rendit të ditës pa ndryshime.

- I jepet fjala për projekt-vendimin **e pikës 11**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Edhe pikën 11, ne e votuam pro dhe ftojme Këshillin që ta miratojë sot. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Musaraj.

Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave e Tarifave, z. Rolant Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj: Edhe komisioni jonë, me shumicë votash, e kalon këtë pikë për miratim në mbledhjen e Këshillit.

Denisa Luarasi: Faleminderit, z. Xhelilaj.

Komente, pyetje ka për pikën 11?

Po, Muka.

Ardian Muka: Përsa i takon pikës 11, në vazhdim edhe të debatit që bëme për pikën 4 dhe 5, për miratimin e përdorimit të fondit të trashëguar nga bashkia nga viti 2025, e thamë: Në një buxhet 110 milion euro kemi një mosrealizim 32 milion euro, të cilat mbarten për vitin 2026. Neve këtë debat realisht e bëjmë që ta dëgjojnë qytetarët. Neve jemi të bindur për atë që ndodh. E thamë, për mendimin tonë ka një mosefiçensë nga ana e bashkisë në realizimin e fondeve në dispozicion, me gjithë problematikat e mëdha që ky qytet ka. Pastaj, vit elektorale, jo vit elektorale, për ne është inekzistente. Jemi këtu për t'u shërbyer qytetarëve, vit elektorale ose jo.

Një koment do kisha gjithsesi për këtë pjesë. Ka një shpërndarje jo të studiuar përsa i takon fondeve shtesë dhe pa një transparencë, sepse këto nuk janë realizuar gjithmonë për vitin 2025. Për mendimin tim duhet të shkonin në drejtime të tjera, por për aq sa neve arrijmë të incidojmë në këtë proces, po e themi, po deklarojmë votën tonë kundër, jo për mosrialokim të fondeve, por për mënyrën sesi këto fonde janë administruar.

Meraku jonë është: Në 2026 do t'i shtojmë këto 32 milion euro, ndërkohë që kemi buxhetin tonë, dhe nuk duam që të vijmë në vitin 2027 me 50 milion euro të mbartura nga viti 2026.

Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zoti Muka.

Po, Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë, z. Muka, me gjithë respektin që kam për ju, në disa raste jeni realisht me logjikë të ftohtë dhe jeni me këmbë në tokë. Në pikën që ju deklaroni votën kundër, do doja të dija, nëse e keni të mundur të më jepni përgjigje në këto momente, nëse jo mund të merrni kohën tuaj : Cilat janë ato problematika ku i keni parë fondet e shpërndara dhe ku mendoni ju konkretisht, duke u nisur nga hallet që ju paraqisni në çdo mbledhje të qytetarëve, ku mendoni dhe në ç' masë e në ç' shumë duhet të shkojnë këto fonde?

Do doja të dija konkretisht nga do ta marrim shumën ku e ka parashikuar bashkia dhe ku mendoni ju kishte më vlerë dhe do ishte më emergjente.

Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Musaraj.

Ardian Muka: Atëherë, unë shqetësimet i ngrita edhe kur diskutuam për pikën 4. Natyrisht, thashë ka në rialokimin, rishpërndarjen e fondeve që ju propozoni. Do preferoja që të ishin zërat që unë thashë më sipër, pra për pjesën e kanalizimeve, pra për infrastrukturën e tërheqjes së ujërave nëntokësore në zonat ku ne kemi pasur problematika gjatë vitit 2024-2025. Do preferoja që këto fonde të ishin shumë më tepër të përqendruara në këtë zë.

Pjesa tjetër ka lidhje me infrastrukturën, rrugë të reja në zonat urbane dhe zonat rurale. Një zë i rëndësishëm do ishte përsa i takon shpronësimeve që ne do t'i japim projektit TID. Ndoshta nga ana e bashkisë, me një iniciativë të bashkisë, të aprovuar nga ana e Këshillit dhe nga fondet tona, neve të shihnim mundësinë që të ndihmonim atë proces që tashmë qeveria ka filluar dhe po rishqyrton. Por pse jo, nëse ne kemi mundësi, i kemi këto fonde, t'i rialokojmë edhe për këtë pjesë, në mënyrë që projekti TID të merrte jetë dhe për qytetin të fillonte rivitalizimi i asaj zone, e cila, për fat të keq, sado një zonë qendrore në qytetin tonë, është një zonë goxha e amortizuar me godina dhe objekte të vjetra, të cilat duhet të rivitalizohen.

Gjithashtu, problem është edhe trajtimi i mbetjeve, që pavarësisht që është i vetmi zë në buxhetin e Bashkisë Durrës që realizohet në 99.9%, megjithatë, në këndvështrimin tim, do ishte e mira që neve të shkonim drejt një procesi tjetër, jo atij të dërgimit të mbetjeve në zonën e Sharrës. E kemi kaluar pjesën e emergjencës, besoj. Duhet të shohim mundësinë e trajtimit të mbetjeve në qytetin e Durrësit, të kalojnë në procesin e riciklimit, ku mbetjet e qytetit mos të jenë një peshë për qytetarët, por të jenë një e ardhur plus, në mënyrë që bashkia ta ketë për ta riinvestuar, ndoshta në po të njëjtin sektor, nga viti në vit.

Këto unë i thashë, por në qoftë se doni mund t'i bashkëngjis edhe shumë procedura të tjera, më fal, shumë halle të tjera që qyteti ka.

Po flasim për këto 30 milion që ne i kemi, por nuk i kemi realizuar dhe tani po i kalojmë për vitin 2026. Faleminderit.

Joniada Musaraj: E di ku e kam problemin unë, zoti Muka. Ju e keni të drejtën e fjalës. Z. Muka, keni të drejtën e fjalës, keni dhe gëzim sot se jeni bërë kryetar. Jam shumë dakord, ju uroj suksese, por të lutem mos abuzoni me mënyrën sesi i paraqisni përpara qytetarëve materialet që përgatit administrata e bashkisë.

Ju vini këtu, mund t'i lejohet një qytetari. Kujtoj që para shumë vitesh, kur i pyesnin kush e ka fajin për këtë, e ka shteti, shteti, dhe nuk e ndante konceptin e shtetit nga institucionet. Por ne këtu në Këshill nuk na lejohet të flasim në mënyrë të përgjithshme dhe të bëjmë sikur këto para i kemi në xhep, i marrim tufë nga një xhep, i çojmë te mbetjet pa studim, i marrim, i fusim këtej, i nxjerrim këtej, një shumë tjetër e çojmë se do zoti Muka te projekti TID.

Zoti Muka, ju jeni të paqartë. Unë e di, jeni çoroditur, keni humbur busullën, unë e kuptoj, por nuk është taksirati as i yni, as i qytetarëve, që vini sot, harxhoni kohën tonë dhe të qytetarëve dhe të mediave, dhe i hidhni fjalët në shesh. I marrim këtej paratë, i çojmë këtu, i marrim andej, por nuk funksionon kështu.

Mua mund të më lejohet si juriste, që nuk marr vesh nga ana financiare, të shprehem në një mënyrë të përgjithshme, por tani, nëse merrni përsipër... Sot, nëse e keni vënë re, nuk e kam marrë përsipër të flas në disa pika në momentin që unë e shikoj që dikush tjetër ka më shumë informacion dhe është më i zoti që ta sqarojë. Mos merrni përsipër të flisni për çdo pikë që është e mundur kur ju nuk e keni informacionin. Dhe po ju them, edhe në pikën 4 ju manipuluar shifrat. Nuk e mora përsipër të ta merrja fjalën, të lashë të flisje. Manipuluar shifrat dhe na nxorët me 2 buxhete, 3 buxhete, çu këtej, çu andej.

Të lutem tani, po të lutem për respekt jo tonin, të qytetarëve, mos dezinformo publikun, mos i zhbëj dokumentet që sjell administrata e bashkisë. Herë tjetër, kur vijnë materialet 5 ditë përpara, i vijnë Këshillit Bashkiak, merr përsipër të sjellësh një studim të planifikuar se ku shkojnë këto para që i marrim këtej ne, që na thoni ju, dhe i çojmë në anën tjetër të xhepit.

Kaq kisha.

Denisa Luarasi: Faleminderit.

Flutura Kasa: Ai vetë e tha, flas me më dëgju qytetarët. Domethënë, nuk flet për me zgjidh problemin, po flet me e dëgju. Prandaj i thashë më herët që, zotëri, ke gjithë ato zyra, bjeri tak-tak-tak. Kush nuk ta hap, shkoji kryetares dhe thuaj: Kjo zyrë nuk përgjigjet për këtë gjë. Prandaj është administrata, nuk është për të bërë fresk.

Denisa Luarasi: Më fal Munir, mund të flasë Muka, meqë...?

Munir Konesha: Kokën e ke vetëm te Muka...

Denisa Luarasi: Mirë, vazhdo.

Munir Konesha: Na fal e, unë kam më shumë një pyetje dhe interesohem, meqë investimet e infrastrukturës. Në buxhetin e vitit 2026, zonja kryetare, ju i përcaktuat me të drejtë dhe ju kam përgëzuar për infrastrukturën që nxorët zë të veçantë, Durrësin e Ri këtu. Meqenëse janë përcaktuar në total për infrastrukturë për njësitë vendore: A ka përsëri Durrësi i Ri në këto fonde shtesë në parashikim?

Ardian Muka: Atëherë, për 5 ditë kohë nga momenti që neve na është paraqitur raporti, është e pamundur nga ana jonë të ndërtojmë një raport me propozime konkrete. Po japim sugjerime bashkisë, meqenëse po diskutohet për një rishpërndarje të këtyre 32 milionë euro apo 30 miliardë e diçka lekë të vjetra dhe i sugjeruam ato kush mund të jenë fushat. Natyrisht, në qoftë se nga ana e bashkisë do të na kërkohet një asistencë për këtë pjesë, neve jemi këtu edhe për këtë gjë.

Përsa i takon dezinformimit, unë kam lexuar me pikë dhe me presje thjesht pjesën e raportit që na është sjellë nga ana e bashkisë. Dhe raporti të gjitha shifrat që unë përmenda, ndoshta mund të kem lënë ndonjë për efekt kohe, të gjitha shifrat janë në raport. Do t'i bëj publike këto që edhe njerëzit ti kenë mundësi t'i shohin, pjesë e këtij raporti, nëpërmjet rrjeteve sociale, sepse aty e kemi mundësinë. Përsa i takon çorientimit, qytetarët e shohin sot e kësaj dite kush është i çorientuari.

..... *Flet Joniada Musaraj pa mikrofon.....*

Denisa Luarasi: Joniada, të lutem.

Ardian Muka: I çorientuari është dikush tjetër, ai që po del të bëjë karagjozin ekran më ekran. Neve jemi këtu.....

Denisa Luarasi: Ju lutem, mos më dilni jashtë rendit të ditës.

Ardian Muka:për të diskutuar hallet e qytetarëve dhe nuk jemi as të çorientuar, as të disorganizuar. Ju faleminderit.

Denisa Luarasi: Kryetare, do e merrni fjalën?

Emiriana Sako: Atëherë, në parantezë, ju Muka thatë që flas për qytetarët, por ju e dini shumë mirë se çfarë do të thotë kur një buxhet ka, me fjalë të thjeshta ka mbimbledhje të të ardhurave. Automatikisht ato para janë në gjendje për t'u shfrytëzuar dhe rishikimi i buxhetit nga 2025 në 2026 na jep mundësinë t'i ripërdorim ato fonde.

Pra, nuk është fondi i paralizuar për arsyet që ju përmendët, por është fond, i cili në bashki ka hyrë me shumë të ardhura të mbledhura dhe kryesisht kanë qenë taksa infrastrukture ato që janë jashtë parashikimit, sepse në parashikimin e taksave dhe tarifave tona vendore e kemi me një progresiv të qëndrueshëm dhe u qëndrojmë atyre shifrave, ndërsa vitin që shkoi ka pasur më shumë taksa të infrastrukturës, të cilat janë paguar në Bashkinë e Durrësit dhe janë kryesisht zhvillime të hoteleve në zonat turistike.

Së dyti, ju thoni paraprakisht që votoj kundër buxhetin dhe ndërkohë ngrini shqetësimin e përmytjeve, ngrini shqetësimin e mbetjeve, të koshave, të trajtimit e të tjera me radhë. Ndërkohë,

ky buxhet, që ju e deklaroni votën kundër, parashikon pikërisht në zërat përkatës pastrimin dhe riparimin e sistemit të kanalizimit të ujërave të shiut, e cila është një problematikë shumë e madhe e qytetit të Durrësit, me të cilën ne dhe qytetarët patjetër u hasëm në janar të këtij viti dhe në janar të vitit që shkoi dhe për këtë kemi marrë masa duke punuar respektivisht për pastrimin e kanaleve, për prishjen e atyre kanaleve që janë zënë në mënyrë të paligjshme nga banorë në zona të caktuara dhe sigurisht kjo nuk ka ndodhur në një ditë. Kjo ka ndodhur në gjithë periudhën e tranzicionit, kryesisht në zonat informale, në zonën e Durrësit të Ri, në zonën e Nishtullës, në zonën e Shkozetit dhe plazhit mbi shina, le të themi. Aktualisht jemi duke punuar në rrugën Sirius, ku lidhet dhe intersektohet bashkë me një zonë të caktuar të Shkozetit. Aty kemi bërë hapjen e gjithë kanaleve, të cilat banorët i kishin futur brenda oborreve me tuba të mbyllur, me seksione sipas secilit mendjes së vet dhe përveç këtyre, kishin edhe mure rrethuese mbi këto.

Dhe kjo, sigurisht, është një punë që nuk do të bëhet në një ditë, sado që dëshirojmë unë dhe ju s'ë vë në diskutim që të zgjidhet një orë e më parë. Pavarësisht kësaj, ju deklaroni që vota është kundër dhe praktikisht po votoni kundër pikërisht këtyre zërave që ne i kemi në buxhet.

Përveç rrugës Sirius, ne po punojmë edhe në shëtitoren Taulantia, ku do të bëjmë një bypass. Pra, është duke u punuar projekti dhe ujërat që mblidhen në zonën e pishinës do të kenë një dalje direkt në det, që do të bëhet në një farë mënyre një nënstacion për të bërë shkarkimin gjatë periudhës së reshjeve.

Një zë tjetër shumë i rëndësishëm i këtij buxheti është ndërtimi i KUB-së në lagjen 17, pranë zjarrfikëses, te rruga e lagjes Jahja Ballhysa. Kjo është një zonë që mban një sasi të konsiderueshme uji edhe në reshjet më të pakta dhe mendojmë që këto elemente, pra fondi i parë i cili parashikon pastrimin e KUB-së, do të ndahet në rrugën Vllazërimi, pra nga rrethrotullimi i burgut dhe përgjatë gjithë rrugës Vllazërimi ne do të testojmë gjithë aksin ku ndodhet tubacioni i ujërave të shiut, do të bëjmë pastrim aty dhe më tej do të vlerësojmë financimin. Një projekt për këtë zonë e kemi, por duam që të kontrollojmë njëherë gjëndjen ekzistuese të këtyre kanaleve, le të themi, dhe më tej të investojmë, të vendosim në buxhet për ta investuar.

Së dyti, duam të punojmë në kanalin e ujërave të larta në Spitall dhe ai është një objekt i joni, sepse ka një ndarje të kompetencave midis njësisë vendore dhe ujësjellës-kanalizimeve. Pra, nuk janë të ndara qartë kompetencat se çfarë duhet të bëjë bashkia dhe çfarë duhet të bëjë secili institucion. Kjo po bëhet me një ligj të posaçëm në institucionet përkatëse dhe është shumë e rëndësishme që këtë punë ta çojmë përpara duke e miratuar buxhetin. Unë ju ftoj që të reflektoni edhe një herë para momentit të votimit dhe ta miratoni në respekt të asaj që ju thoni, për të mbrojtur interesat e qytetarëve.

Më tej, një zë tjetër i rëndësishëm, të cilin ne jemi duke e hasur, si të thuash, çdo vit që kalon emergjencat civile janë një sektor, që ka nevojë për një mbështetje shumë të rëndësishme dhe të konsiderueshme për arsye të kushteve natyrore me të cilat përballlet sot çdo qytet evropian, por dhe Shqipëria dhe Durrësi.

Ne para pak ditësh patëm një rrëshqitje të kodrës në zonën e Vilës, rrëshqitje e cila ka ndodhur edhe disa herë gjatë muajit janar, në periudhën e reshjeve. Ne, që pas janarit, kemi kërkuar mbështetjen e institucioneve për të bërë të mundur analizat gjeologjike të kodrës dhe për të bërë të mundur që të hartojmë një projekt të detajuar, në mënyrë që të kemi mundësi ta financojmë.

Sigurisht, do të jetë një projekt shumë i rëndësishëm dhe do të jetë një projekt që do të ketë një vlerë të madhe. Besoj që nuk do të mbulohet dot nga bashkia, por do të kërkojmë mbështetje në

qeveri dhe mbështetje në fonde ndërkombëtare, sepse ka mundësi financimi, besoj, edhe nëpërmjet fondeve të Bashkimit Europian për çështjet e mjedisit.

Këto ishin ato gjëra që doja të thoja. Ju thoni pse nuk kalon një fond për shpronësimin e TID-it. Ne e kemi diskutuar disa herë projektin këtu. Është një projekt shumë i rëndësishëm për qytetin, dhe ne këtë e besojmë, por nga ana tjetër është të dëgjojmë edhe zërin e banorëve dhe shqetësimet e tyre.

Sigurisht, pas takimit që është bërë me ta dhe me Kryeministrin, ne menjëherë i kemi bërë kërkesë institucionit të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sporteve, ku i kemi kërkuar AZHT-së dhe AKPT-së ngritjen e një grupi të përbashkët pune, sepse një ndër kërkesat ishte të rishikohen edhe një herë objektet nëse mbartin vlera historike apo jo.

Në fakt, para pak javësh, para dy javësh, ka qenë një grup pune nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, me përfaqësues të Bashkisë Durrës, të cilët kanë dalë dhe kanë parë të gjithë objektet. Së dyti, i kemi drejtuar një shkresë Agjencisë Kombëtare të Shpronësimit, ku i kërkojmë që të rishikohen vlerat e shpronësimeve, pasi ne kemi vlerësuar dhe kemi bërë një analizë të tregut dhe kemi parë që realisht, në ato vlera, sigurisht që të gjithë e dimë, të gjithë jetojmë në Durrës, ata nuk e kanë të mundur të blejnë një banesë tjetër. Për këtë arsye, ne besojmë se kjo kërkesë e jona do të merret në konsideratë dhe do të bëhet e mundur që kjo vlerë e shpronësimit, nga ajo që ne kemi marrë nëpërmjet ASHSH-së apo ajo që na tregon ligji, të rishikohet vetëm për projektin TID të Durrësit.

Kështu që unë ju ftoj të reflektoni dhe ta konsideroni votën tuaj për të mirën e qytetarëve.

Faleminderit.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit, znj. kryetare.

Po, Muka.

Ardian Muka: Do e përshëndesja realisht pjesën e sinjeritetit të kryetares kur tha që, realisht, për 2025-ën ne kemi pasur kuadrin e transparencës natyrisht, kemi pasur të ardhura më shumë, por kanë qenë të paprogramuara, meqenëse ato kanë lidhje me fondin e, më fal, me zërin e pjesës së infrastrukturës. Pra, meqenëse nuk dihet se sa leje do të kërkojnë dhe automatikisht ne nuk mund ta parashikojmë atë në buxhet. Por për të gjithë pjesën tjetër të cilën kryetarja përmendi, ne i kemi thënë dhe kam qenë të paktën unë me zë dhe figurë këtu në Këshillin Bashkiak që kam kërkuar që t'i vëmë një fond në dispozicion. Meqenëse, në qoftë se nga ana e bashkisë nuk do të bëhet dot e mundur të kishim një projekt apo një studim të mirëfilltë për pjesën e të përmblyturve, të çelim neve një fond si bashki dhe të marrim studiot më të specializuara, kush mund të jenë, që të na japin aty ku janë problematikat dhe neve të shkonim dhe të ndërhyjmë.

Jeni të gjithë dëshmitarë të këtyre që unë po them. Problematikën e shembjes së kodrës së Currilave, siç e njohim këtu në qytetin tonë. Ne kemi një problematikë prej vitesh. Kemi dhënë disa projekte atje. Në qoftë se i mbani mend, jam ndërhyrë disa herë në pjesën e kodrës. Asnjëherë nuk është bërë me seriozitetin e duhur dhe fakti është që ne sot jemi aty duke dhënë edhe leje ndërtimi në pjesën e kurorës së kodrës dhe, gjithë tani, po shohim që ato shtëpi që janë ndërtuar në pjesën e sipërme të kodrës janë të gjitha të rrezikuara që, në harkun e një apo dy viteve, unë nuk e uroj, por ndoshta me ndërhyrjen që do bëjmë do t'ia arrijmë t'i shpëtojmë, por ndryshe ato do jenë të gjitha, do t'i gjejmë në bregun e detit.

Po ashtu edhe për projektin TID. Pra, e dimë që kjo është një problematikë. Zgjidhja, okej, vjen si zgjidhje politike, pra duke shkuar, duke folur me banorët, duke gjetur gjuhën me ata, por tek e fundit është një zgjidhje ekonomike. Ato banorë nuk janë kundër projektit, janë për transparencën e projektit dhe pjesën tjetër thonë: Ne projekti të zhvillohet, por ne të marrim atë çfarë na takon. Për këto të gjitha që unë po them, pjesërisht juve i keni hedhur në atë çfarë këto 30 e ca miliardë i kemi trashëguar, i keni parashikuar në buxhetin që propozoni, por ndërhyrja, për mendimin tonë, dhe prandaj thashë, duhet të ishte më radikale në këto që janë problematika.

Pse? Për ato çfarë ne për 2026-ën kemi programuar, ne i kemi të parashikuara në buxhet. Në këtë shtesë, ne të shkonim dhe të zgjidhnim këto që kemi problematika akute, pra një, dy, tre që janë më kryesoret, të shkonin dhe tu investoni në këtë pjesë.

Këtë propozim dhamë ne dhe për këtë pjesë jemi kundër. Nuk jemi kundër që këto lekë do të riallokohen për vitin 2026.

Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit, Muka.

Atëherë, të nderuar kolegë, ju ftoj në votim, ta votojmë buxhetin.

Shumë faleminderit.

Me 30 vota pro miratohet dhe pika, dhe 9 kundër. Faleminderit, Dori, pika 11 e rendit të ditës.

- Jepet fjala për projektvendimin **e pikës 12** Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Kotë nuk thonë: “I mbyturi të mbyt.” Ashtu i mori dhe zoti Muka me vete gjithë anëtarët.

Denisa Luarasi: Jo, të lutem

Joniada Musaraj: Nejse, atëherë edhe për pikën 12, komisioni ynë votoi pro dhe fton këshillin që ta miratojë sot. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Musaraj.

E merr fjalën Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, zonja Marsida Feshti.

Marsida Feshti: Përshëndetje.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakord që pika 12 të kalojë për votim në këshill. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Komente? Pyetje kemi për pikën 12 të rendit të ditës?

Po, Muka.

Nuk e ke thërritur mikrofonin?

Ardian Muka: Do të doja të dija nga ana e administratës së bashkisë lista emërore, e cila ka dalë si pjesë e këtij projekti Pra, përse i takon miratimit të përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit dhe objektet me radhë, ne kemi aprovuar disa lista, disa lista emërore. Do doja të dija:... këto banorë janë ata që po transferohen, që kanë dhënë dakordësinë e tyre, pra ku pallatet

janë shembur dhe kanë dhënë dakordësinë e tyre për t'u transferuar në zonën e re që është ndërtuar në zonën e Porto-Romanos?

Emiriana Sako: Janë 76 familje që miratohen këtu. Duke qenë se ne vendimet në këshill i kemi miratuar, pra si fillim kemi shpallur fitues kryefamiljarin, subjektin, dhe pastaj kemi bërë destinacionin. Pra, cilën nga tipologjitë e programit përfiton? Grant për ta rindërtuar vetë apo banesë në Spitallë apo banesë në Manzë e të tjera.

Këto janë të miratuar, të cilat marrin destinacionin tashmë. Pra, 54 familje shkojnë në zonën e Spitallës, sipas dakordësisë së tyre, dhe 22 të tjera janë tek Teodor Rupit, tek objekti për të cilin ka filluar prishja. Miratohen familjet përfituese në këtë objekt.

Teodor Rupit ka zgjatur, sepse ato kanë qenë pjesë e një granti DS3. Duke qenë se ekspertiza tregoi që objekti duhet prishur për arsye të inklinimit të madh që kishte objekti, atëherë u bënë procedurat e rikthimit, sepse duhet të dalësh nga një program dhe të futesh te programi tjetër. Pra, nuk mund të përfitosh edhe grantin, edhe apartamentin.

Kështu që ata kanë kthyer pagesën pranë Bashkisë së Durrësit dhe tashmë miratohen si përfitues përsa i takon apartamentit, në momentin që përfundon procesi i rindërtimit. Edhe prishja e objektit ka filluar. Është një proces disi kompleks, sepse është një objekt shumë i madh, i ndodhur në një zonë me intensitet të lartë urban dhe e kemi vendosur që prishja duhet të bëhet manuale. Ka filluar nga pjesa e sipërme, drejt zbritjes në katet më poshtë.

Denisa Luarasi: Faleminderit, kryetare.

Ardian Muka: Jo, kisha disa pyetje. Do preferoja, meqenëse është kryetarja, të përfitoj nga rasti t'i marrim përgjigjet direkt nga ajo.

Tani, për disa nga këto jemi të qartë, por kjo është edhe për efekt të qytetarëve që na dëgjojnë.

Atëherë, pronësia e apartamenteve të cilat këto banorë po marrin në zonat e reja, pra në zonën e Spitallës apo në zonën e Manzës, do t'u ngelet 100% banorëve dhe si trashëgimi? Pra, ata kanë të drejtën e pronësisë 100% mbi godinën, do ta trashëgojnë, mund ta shesin, mund ta tjetërsojnë atë godinë dhe të dalin me një godinë tjetër në një moment të dytë?

Si preferoni, t'i bëj pyetjet një nga një dhe të më jepni përgjigje apo t'i bëj të gjitha? Okej.

Atëherë, kemi një rast i cili kërkon gjithashtu sqarim. Në momentin që edhe për pallatin që ju përmendni ka banorë, të cilët kanë pranuar të jenë pjesë e këtij projekti, pra të spostohen në zonën e Spitallës, por ka edhe banorë, të cilët nuk kanë preferuar të spostohen dhe do presin që bashkia të ndërtojë në këtë rast në të njëjtin vend.

Ka një detaj teknik për sa i përket pronësisë së tokës.

Banori i cili pranon të spostohet dhe të ikë në zonën e Spitallës, përqindjen e tokës që kishte nën ndërtimin që ai po lë, ia kalon shtetit, në këtë rast bashkisë? Dhe si do të trajtohen marrëdhënia me banorët e tjerë?

Pastaj, kujt do t'i përkasë pronësia në terren, pra pronësia që ngelet mbi territorin e ndërtesës së re që do ndërtohet, meqenëse do jetë një miks? Pra, një pjesë do jenë banorë, të cilët bashkia i fut nga procesi i rindërtimit dhe ndoshta pjesa tjetër mund të jenë banorë, që hyjnë nga projekte të tjera, ato që janë në pamundësi strehimi apo banorë çifte të reja dhe të gjitha projektet që ka bashkia.

Dhe një pjesë tjetër. Kur kemi rastet që ndërtesat kanë qenë private, është shembur godina si godinë private, por privati ka shitur brenda edhe pjesë të personave të tretë. Në momentin që kjo godinë shembet nga tërmeti dhe ky privat, për pallat po flasim për pallat, një pjesë e këtyre banorëve janë transferuar në zonën e Spitallës dhe privati kërkon të rindërtojë në të njëjtin vend, si do trajtohet ky rast? Pra, akti i pronësisë mbi truallin. Banorët që kanë qenë aty janë spostuar, privati është prezent dhe kërkon të rindërtojë në të njëjtin vend. Si do të merrte zgjidhje kjo? Sepse, me thënë të drejtën, e kam kërkuar në rrugë informale, por për momentin nuk më është dhënë përgjigje. Faleminderit.

Emiriana Sako: Ne kemi pasur disa raste, sepse çështja e pronës është sigurisht shumë e ndjeshme, por nuk është thelbi i programit të rindërtimit çështja e pronës së objektit të prishur. Pra si fillim, objektet për të cilat banorët marrin çelësat si përfitues, do t'i kenë pronat e tyre me të drejta të plota deri në regjistrimin. Ne kemi ngritur një grup pune në bashki, sepse duke qenë se pjesa më e madhe e tyre janë ndërtuar nga qeveria, nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, ose në rastin e Spitallës nga donatorë të huaj, atëherë Këshilli i Ministrave bën një procedurë të parë, me të cilën, me VKM, i transferon nga ndërtuesi apo zhvilluesi. Ne jemi përfitues në këtë rast, por mund të quhemi edhe zhvillues, sepse kemi interesin që të bëhet objekti. Kalon nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, kalojnë në pronësi të Bashkisë së Durrësit dhe më pas ne, me deklaratë noteriale apo vendim të këshillit, duhet ta shohim teknikisht se si do të bëhet transferimi i pronës tek subjekti përfitues. Paralel me këtë do të bëhet aplikimi për certifikatë përdorimi. Pra, do të bëhen të gjitha procedurat si për një leje ndërtimi të mirëfilltë, duke filluar nga certifikata e përdorimit. Pasi ta nxjerrim, do ta regjistrojmë në hipotekë dhe në fund qytetari do të marrë aktin e dhurimit në fund të procesit. Aktualisht jemi duke punuar me Manzën, duke qenë se është lagja e re, e cila ka përfunduar e para dhe VKM-ja është bërë gati. Do të dalë VKM-ja që i kalon në pronësi Bashkisë së Durrësit dhe pastaj ne do të bëjmë procedurat përkatëse me kalimin e pronësisë tek qytetarët, të cilët do të kenë, që në ditën numër një që marrin certifikatën e pronës, të drejtë ta shesin, ta dhurojnë, ta japin me qira e të tjerë me radhë.

Kemi një shembull të pallati i cili u prish në plazh. Aty banorët kanë refuzuar të përfitojnë apartamente në zonën e re të Spitallës apo në qytet, sepse duan që ta zhvillojnë sërish objektin vetë. Normalisht, në momentin që je përfitues nga ana e Bashkisë së Durrësit, automatikisht atë pjesë të tokës që ke të një pallat i caktuar, e drejta e saj humbet. Supozohet që i kalon shtetit, Bashkisë së Durrësit, le të themi. Pavarësisht se ne nuk jemi marrë me këtë proces, sepse nuk kemi kërkuar të regjistrojmë pronarin e apartamentit X, i cili ka përfitur në Spitallë dhe ka 2 m truall të pallati në Spitallë apo pallati në Shkozë apo ky në hyrje të Durrësit, sepse ky është një proces i cili do detajuar me kujdes. Prioritet kemi pasur të strehojmë banorët dhe jo të merremi me pronat, një apo dy metra katrorë që ata lënë të prona e përbashkët. Ka raste që mund ta kenë bërë, por ka raste që nuk e kanë bërë regjistrimin ose pjesëtimin e sipërfaqes së përbashkët. Kështu që këto janë çështje që do të shihen rast pas rasti.

Megjithatë, në qoftë se do të kesh ndonjë rast që ka ndonjë ankesë konkrete, por shembulli që kemi në plazh është se ata kanë refuzuar ta marrin, sepse automatikisht i bie që do të duhet të heqin dorë dhe bashkia do të futet në lojë për pjesën e truallit që mbetet. Këto ishin për objektet. Pra, bërë edhe një pyetje tjetër: Çfarë do të ndodhë në qoftë se te ky pallat ku ka qenë pronar një subjekt i caktuar vjen dhe futet edhe një familje tjetër?

Duke qenë se te Teodor Rupi disa familje kanë thënë: “Jo, ne duam të qëndrojmë në Spitallë”, edhe sepse objektet kanë mbaruar dhe jemi pak më herët sesa të presim sa të ndërtohet objekti, çfarë do të bëhet me apartamentet e mbetura? Akti normativ nr. 5 i ka lejuar bashkisë që në krye të herës, që kur është konceptuar si ligj, të kërkojë edhe numra shtesë apartamentesh që t’i përdorë me qëllim social, që do të thotë banesa, të cilat do t’u jepen me qira me kosto të ulët.

Ne po shqyrtojmë edhe rastin e shkëmbimit për banorët e TID-it. Për shembull, në qoftë se do të kemi një alternativë dhe kemi disa apartamente bosh, dhe themi: “Shiko, ne kemi këtë 60 m², hajde me 60 m²”, sigurisht me dakordësi. Ato patjetër do të kalojnë në këshill, sepse ne nuk kemi një instrument që një pallat të ndërtuar nga rindërtimi ta akomodojmë për familje që preken nga një projekt, i cili është interes publik. Pra, ai program është program strehimi në vetvete. Kështu që këto janë detaje të cilat do të shqyrtohen rast pas rasti.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit, kryetare.

Kalojmë, të lutem.

Ardian Muka: Duke kërkuar mirëkuptimin e kolegëve. Janë detaje. Të gjitha ato që unë pyeta janë detaje dhe janë pyetje që banorët e qytetit i kërkojnë.

Edhe thashë, unë përpiqem t’i sqaroj, por është më mirë kështu, në mënyrë publike dhe nëpërmjet mediave, ta kenë këtë sqarim automatikisht, direkt nga goja e kryetares.

Është shumë e rëndësishme ajo që thamë. Pra, trualli i banorëve, pallatet e të cilëve janë shembur dhe janë transferuar në godinat e reja, duhet të shihet me urgjencë që të merret në pronësi nga ana e bashkisë. Pra, nuk është thjesht diskutim për një, dy apo tre metra katrorë. Janë ndoshta 50 banorë që nga 3 m² secili bëjnë 150 m² truall dhe këtë truall ta marrim dhe ta shfrytëzojmë.

Zonja kryetare, unë jam banor i lagjes gjashtë. Në lagjen gjashtë kemi pasur një pallat të Bonifikimit që u shemb. Të gjithë banorët janë sistemuar, nuk e di si, por janë të sistemuar.

Atëherë ai truall aty për momentin është bosh.

Ku? Tek lagjja gjashtë, te shkolla “Dy Gjelat”. Atëherë ai truall është një truall i preferuar po themi, i cili, në qoftë se do të ishte në pronësi të bashkisë, meqenëse të gjithë banorët janë të sistemuar, mund të ndërtohej një ndërtesë që mund të sistemonte nesër banorët e TID-it, duke i dhënë një zgjidhje asaj plage që tani po na mban projektin për momentin të bllokuar.

Dhe si ky rast, ne kemi edhe godina të tjera, sipërfaqet e të cilave janë lënë të lira dhe janë zona brenda qytetit. Sepse po shohim që ka një reagim: banorët nuk spostohen, sepse thonë: “Nuk mund të shkojmë në zonën e Spitallës unë që kam shtëpinë në mes të Durrësit.”

Atëherë do të shihej si zgjidhje lagjja gjashtë apo lagjja pesë, apo lagje të tjera që do të shemben, ose këto sipërfaqe janë të lira. Të shihej me precedencë kalimi i truallit në funksion të bashkisë, të shtetit, dhe aty të ndërtohej në këto sipërfaqe që janë sipërfaqe të lakmueshme, sipërfaqe të mira, brënda, afër qendrës së qytetit. Këtu të ndërtohej në funksion të këtyre banorëve.

Për këtë e thashë që ndoshta legjislacioni, nga ana juaj dhe nga ana jonë, të përmirësohet dhe ta shtyjë këtë proces që sa më shpejt ne ta kemi këtë mundësi dhe të kemi këto troje në dispozicion të bashkisë për t’u dhënë zgjidhje nesër këtyre problemeve që kemi për strehimin.

Faleminderit.

Edlira Shemsi: Kryetare, mund t’ju bëj një pyetje?

Denisa Luarasi: Prit, znj. Shemsi...

E ke bërë dhe herë tjetër këtë , të lutem...

Të flasë kryetarja.

Emiriana Sako: Po, në lidhje tjetër, banorët e projektit TIT, ne kemi kërkuar kur kemi bërë takime me ta dhe i kemi propozuar lagjjen e re të Spitallës, nuk kanë pranuar dhe ne do të sigurohemi që zgjidhjet e tyre, qoftë për këmbim, qoftë për rritjen e vlerës së shpronësimit, që janë dy instrumente të ndryshëm, t'i sigurojmë brenda qytetit, pra brenda pjesës së qytetit, pra brenda, nuk po them zonës A se atë do duhet çfarë mundësisht kemi, le të themi për, por do t'i sigurojmë që apartamentet ata t'i kenë apo mundësinë për të blerë një apartament ta kenë në qendrën e qytetit.

Edlira Shemsi: Në kuadrin e kësaj të pronësisë së truallit, doja ta pyesja zonjën kryetare në lidhje me pallatet që janë ndërtuar dhe në zonat ku kanë qenë ekzistuese. Ndërkohë janë futur brenda banorët që kanë për banim, për poshtë janë ato që kanë qenë për shërbime, për aktivitete të ndryshme, të cilat ata që i kanë poseduar i kanë pasur me certifikata të rregullta hipotekore, me akte shitblerje e të tjerë.

Ndërkohë janë ndërtuar, ato rrinë bosh. Akoma këta që i kanë dhe sot e kësaj dite aktet hipotekore nuk e dinë pse nuk i marrin në dorëzim ato objekte, që aty ata i kanë pasur dhe janë ndërtuar tashmë. Çfarë do bëhet me këto? Në kuadrin e kësaj që kanë pronësinë me truallin, ato e kanë pronësinë me truallin. Këto sua heq dot njeri se e kanë me ligj, sepse e kanë me akt hipotekor. Çfarë do bëhet me këto? Ato kanë pasur shërbime aty, kanë jetuar me shërbim ato familje.

Këtë do pyesja kryetaren.

Emiriana Sako: Po, është pyetje shumë e drejtë kjo. Ne i kemi kërkuar qeverisë që këto janë gjashtë apo tetë subjekte, të cilët kanë pasur dyqane, katet përdhe, le të themi, që këto t'i transferohen bashkisë dhe të bëhet procedura e rikthimit, le të themi, të pronës. Por nuk duhet të harrojmë që ky është një program strehimi dhe merret me familjet e pastreha. Nuk është një program shpronësimi, nuk është prishur prona e tyre për interes publik, nuk është prishur nga institucionet, është prishur nga fatkeqësia natyrore. Kështu që deri në momentin që nuk kemi një transfert të këtyre sipërfaqeve apo objekteve, le të themi, me një vendim të Këshillit të Ministrave, ne nuk i shpërndajmë dot ato. Sigurisht që qytetarët kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës për të kërkuar të drejtën e tyre, që është më e drejtë, siç e thoni ju. Kanë qenë pronarë më përpara, posedojnë pjesë të truallit, mbase, se nuk janë raste të ndryshme, për të marrë të drejtën e tyre.

Edlira Shemsi: Sepse aty nuk është se janë strehuar njerëz, ato nuk janë objekte strehimi, ato kanë ngelur ashtu si objekte shërbimi. Shpresojmë të gjejnë zgjidhje.

Denisa Luarasi: Faleminderit, kryetare. Faleminderit, doktoreshë.

Kalojmë në votim....

Me 38 vota pro dhe 1 kundër, miratohet edhe pika 12 e rendit të ditës pa ndryshime.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 13**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë, edhe për pikën 13 ne si komision ramë dakord që këshilli ta miratojë sot. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Musaraj.

Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës, zonja Jonada Mamo.

Joniada Mamo: Përshëndetje.

Edhe komisioni ynë e miratoi me shumicë votash dhe fton këshillin ta votojë. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Mamo.

Komisioni i Politikave të Zhvillimit dhe Turizmit, zonja Periana Kotri.

Periana Kotri: Edhe komisioni ynë u mbledh dhe me vota unanime vendosëm ta kalojmë sot në rendin e ditës.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Kotri.

Komente, pyetje ka për pikën 13 të rendit të ditës?

Nuk ka. Kalojmë në votim.

Me 37 vota pro, miratohet edhe pika 13 dhe e fundit e rendit të ditës.

Atëherë, ok, duke ju falënderuar...

S'ka pikë 14.

Jo, jo, një minutë.

Jo, jo. Pikë 14 nuk ka.

Ka diskutime. Ju lutem. Po. Jo, pikë 14.

Po. Atëherë, Flutra e ka tërhequr.

Jo, jo. Administrata është.

Edlira Shemsi: Më fal ç'bëhet këtu, unë e kam çuar e kam të dokumentuar më email. Çdo me thënë kjo. Ne këtu për komunitetin jemi.

Denisa Luarasi: Ju lutem të dëgjojmë pyetjet e Edlirës.

Edlira Shemsi: Më fal, kryetare, bëra hatanë shparë që fola një fjalë dhe më ndërpret. Ndërkohë, ju nuk e mbani prezent këtu administratën edhe këshillin kur diskutohet për komunitetin. Të lutem.

Denisa Luarasi: Nuk ta ndërpreva fjalën, por do u përgjigjte kryetarja.

Edlira Shemsi: Të lutem, fjala, të lutem. Më fal, kjo nuk është një pikë e fundit dhe se kalojmë. Pyetjet për komunitetin janë më të rëndësishme dhe për ato jemi këtu.

Ardian Muka: Mbledhja nuk ka mbaruar, znj.kryetare.

Edlira Shemsi: Më fal, administroni mbledhjen.

Ardian Muka: Ju lutem, duke filluar me kryetaren e bashkisë dhe administratën të paktën në respekt të kësaj duhet të jenë të pranishëm, kryetare...

Denisa Luarasi: Kryetarja ishte, ka një takim të rëndësishme. Kemi administratën, kemi drejtori.

Edlira Shemsi: Po ku i kemi, më fal, ku i kemi anëtarët e këshillit?

Denisa Luarasi : Ju lutem....

Edlira Shemsi: Ju lutem, unë juve, se ju e drejtoni mbledhjen. Unë dua të them, ju lutem juve administroni mbledhjen.

Denisa Luarasi: Drejtoresha mund të filloni me përgjigjen e pyetjeve.

..... *flasin shumë këshilltarë përnjëherë.....*

Denisa Luarasi: Edlira do bësh pyetjet?.

Edlira Shemsi: Si të doni juve, ato pyetje i bëj dhe në vend tjetër. Në qoftë se këshilli nuk është i disponueshëm për të dëgjuar pyetje në lidhje me ankesat dhe problematikat e komunitetit..

Denisa Luarasi : Është shumë i disponueshëm. Është ok.

Edlira Shemsi: Po e shof sa i disponueshëm, okej.

Denisa Luarasi : Vazhdojmë me mbledhjen.
Se ka kërkuar, duhet ta kërkoj.

Edlira Shemsi: Po si se kam kërkuar, e kam kërkuar si se kam kërkuar, është administruar si pyetje në rendin e ditës.

Denisa Luarasi: Po them për mikrofonin.

Edlira Shemsi: Pyetja e parë që kam bërë ka qenë në lidhje me dëmshpërblimet e banorëve të përmytur të Kënetës, që janë përmytur dy herë. Janë marrë dy herë ato listat dhe janë administruar dëmet përkatëse dhe ndërkohë, asnjë lloj dëmshpërblimi nuk është dhënë, asnjë përgjigje, sipas informacioneve që na ka dhënë bashkia.....

Denisa Luarasi: Edlira më fal do i bësh gjithë pyetjet apo veç e veç.

Edlira Shemsi: Si të doni Ju ?

Jo, një sekondë, si e doni ju? Më thoni ju.

Dakord, po bëj pyetjen e parë. Po bëj pyetjen e parë, pyetjen e parë.

Sipas informacioneve që kemi nga bashkia, është përpiluar një listë. Tani as dëmshpërblimi nuk ka filluar nga ana financiare të jepet. Si do të jepet kjo dhe kur do të jepet? Ka një prioritet liste, ata që janë dëmtuar më shumë, ata që janë më të varfër, apo do t'u jepet e plotë për të gjithë? Dhe

kur do të fillojë? Sepse fakti që po mbahet peng dhe nuk po jepet ai dëmshpërblim mund të bëjë të mendojmë që po pritet të vijnë edhe dy-tre muaj fushatë dhe të fillojë dhënia selektive e dëmshpërblimit.

Denisa Luarasi: Bëj pyetje, mos jep opinion.

Edlira Shemsi: Jo unë opinionin do ta jap se...

Alneida Rroshi: Në muajin e janarit... Unë jam pjesë e grupit të punës, po jam drejtorja juridike. Dua të informoj që në Bashkinë Durrës janë administruar rreth 2775 dosje nga njësitë administrative ku ka ndodhur përmbytja. Nga këto janë shqyrtuar 1556 dhe ka mbetur pjesa tjetër për të vetmen arsye, sepse banorët kanë pasur të drejtën që gjatë gjithë kohës të sjellin kërkesat e tyre, pranë njësive administrative.

Kemi hasur problematika në titullin e pronësisë dhe certifikatën e pronësisë, apo në ato ambiente apo shtëpi që janë me qera me një kontratë noteriale. Nuk kemi përjashtuar asnjë mundësi që t'i paraqesin këto kërkesa edhe në muajin mars dhe prill. Sigurisht që për ne është shumë i rëndësishme përfundimi i kësaj liste sa më shpejt dhe do të trajtohen të gjithë bashkë me një shumë totale për të gjithë njëherësh. Është një proces i gjatë, që ka dashur bashkëpunimin tonë për të gjitha njësitë administrative dhe po shqyrtohet me prioritet.

Ina Ferra: Jo sipas një përzgjedhjeje nga ana jonë, por sipas listave, kush ka plotësuar dokumentacionin e parë nga ana financiare flasim. Janë likuiduar plotësisht 89 banorë, me vlerë totale i të gjithëve 6.5 milionë lekë të reja. Gjithashtu, kemi një listë me 47 banorë nga lista totale e 342 banorëve, e cila është listë që do të përfitojnë në këste. Pjesa tjetër tani...

Edlira Shemsi: Po mund t'ju pyes? Sa ka qenë lista e parë e kërkesave dhe, ndërkohë, janë kaq që thonë juve, janë shpërndarë 100% apo një pjesë e listës së parë? Se thonë që s'ka marrë asnjëri akoma. Një listë totale.

Ina Ferra: Jo. Një listë është likuiduar plotësisht, ka përfunduar. Jemi te pjesa e listës së dytë, e cila ka marrë një pjesë të vënë në dispozicion kanë qenë.....

Munir Konesha: Ne sapo e miratuam në buxhet. 110 milion lekë të reja.

Ina Ferra: Bravo

Denisa Luarasi: Ina fol me mikrofon. Mos ndërhyri kur flisni.

Edlira Shemsi: Ato kanë marrë kredi dhe overdraft për të rregullur ato banesa....
Ok, kalojmë tek pyetja e dytë.

Ardian Muka: O doktoresha me fal pyetja ndoshta është për përmbytjen e fundit....

Edlira Shemsi: Jo pyeta për të dyja.

Alneida Rroshi: Pyetja ishte për 2026.

Edlira Shemsi: Jo e kam shkruar për të dyja, janë përmbytur 2 herë dhe s'kanë marrë asnjë lloj dëmshpërblimi.

Ina Ferra : Në buxhetin për vitin 2024 e kemi kaluar vetë fondin për përmbytjen.

Denisa Luarasi: Edlira pyetja e dytë.

Edlira Shemsi: Pyetja e dytë, gjithmonë në këtë zonë, me zonën e Durrësit të Ri, që quhet tashmë zona ish-Kënetës. Në këtë zonë, sipas një plani rregullimi të territorit të korrikut 2026, që ka kaluar edhe në këtë mbledhje, të miratuar në korrik 2022, më falni, që ka kaluar dhe në këtë këshill, është një plan i cili kërkon që të ketë zhvillim të territorit, i cili do të përfshijë edhe stokun e shumë prej banesave aty. A ka një konsultim publik dhe dakordësi me banorët e këtyre zonave, se si do të shkojë kjo? Këto banesa do të administrohen nga shteti, do të marrin banesa shtetërore apo do të vijë me marrëdhënie me privatët që të ndërtojnë? Sepse deri tani asnjë...

Denisa Luarasi: Mos ndërhyini kur flisni, ju lutem.

Edlira Shemsi: Për të bërë transparente se si do të ndodhë ky zhvillim territori, që do të shembin një pjesë të banesave, nuk ka akoma me një pjesë të banorëve aty.

Alneida Rroshi: Je duke folur për rrugën Azem Hajdari ?

Ligji e përcakton qartë që shpronësimi ka dy momente : Shkëmbim në para, sipas referencave dhe shkëmbim në natyrë, që është apartament me apartament , sipas VKM-s ne zbatojmë vetëm ligjin. Ne jemi në pritje dhe në bashkëpunim gjatë gjithë kohës me Agjencinë Shtetërore të Shpronësimeve, sepse është një investim që nuk është bërë nga bashkia, por është bërë nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Me thënë të drejtën, është një proces i vonuar, por duke qenë se të gjitha këto prona kanë pasur shumë probleme me titullin e pronësisë. Se ne duhet të jemi të qartë se një pronë për të kaluar në shpronësim publik, duhet medoemos t'i nënshtrohet një regjimi të qartë juridik të pronësisë. Pasi na vë përpara përgjegjësisë. Sigurisht me daljen e VKM-s përcaktohet se kush do të shkëmbehet në natyrë me një apartament tjetër të disponueshëm ose përballë për të bërë shkëmbimin në natyrë të pronës. Në këto momente sipas ligjit do bëhet shkëmbim në natyrë i pronës.

Edlira Shemsi: Banorë të lagjes numër 8, rruga Isuf Fera, që ju e dini, ku do të bëhet zgjerimi i rrugës për efekt të unazës. Pasi ata banorë janë, rrinë realisht ne ancia çfarë do ndodhë me pronat e tyre. Nuk kanë akoma asnjë dakordësi jo e jo, por nuk kanë akoma transparencë se çfarë do të bëhet realisht? Si do të shkojë me banesat e tyre dhe me bizneset e tyre të asaj zone?

Alneida Rroshi: Unë përgjigjen jua dhashë dhe pak më parë, në bazë të ligjit 8561.....

Edlira Shemsi: Që ata nuk do pyeten, se do merren, por sepse ligji nuk e parashikon që ata të dakordësojnë...

Denisa Luarasi : Të lutem ta dëgjojmë.

Alneida Rroshi: Kemi hasur shumë problematika pronësie, titujt e pronësisë, sepse për hir të së vërtetës shumë prona, numra të pasurive, nuk korrespondojnë me pronën që shpronësohet, gjë që sillte një problem të madh, gjë që duhet plotësuar për të vazhduar edhe me procedurat, për të qenë një shpronësim i drejtë, siç ligji e parashikon. Ndaj është duke u shikuar....

Edlira Shemsi: Kërkesa është paraqitur shpeshherë për të marrë strehim social, për të marrë banesë sociale nga një zonjë, Bratilda Ndoja, e cila është e vetmja kryefamiljare pas vdekjes së bashkëshortit. Vetë zonja është e diagnostikuar me sklerozë multiple, me 3 fëmijë minorenë. Ajo jeton me një pension minimal pas vdekjes së bashkëshortit. Ndërkohë, unë e di shumë mirë që në Bashkinë e Durrësit ka 4 vite që nuk jepet asnjë banesë sociale. Më erdhi mirë, shparë, kur tha kryetarja: "Ne duam t'i marrim disa banesa, t'i bëjmë me qera sociale." Zonja në fjalë ka ardhur jo një herë, por shumë herë këtu dhe akoma pa asnjë përgjigje. Si kjo janë shumë, por ky është një rast i veçantë, sepse edhe zonja është shumë e sëmurë dhe bashkëshorti i ka vdek dhe vazhdon dhe ia del, edhe pse me 3 fëmijë minorenë. Mendoj që ka shumë persona që janë në hall dhe në nevojë, por disa janë më tepër siç na e thotë Hygoja "janë më të varfërit e të vafërve" ka dhe kështu dhe duhet të kenë precedencë.

Ina Ferra: Për aq kohë sa nuk ka në dispozicion banesë sociale, unë mendoj se mund ta ndjek vetë këtë çështje. Jam drejtoreshë ekonomike, nuk jam te Shërbimi Social, por mund ta ndihmojmë që të përfitojë nga një prej programeve të tjera të strehimit. Pra, po ta jap fjalën që ta asistojmë.

Edlira Shemsi: E kemi detyrim moral, mbi afatet ligjore...

Ina Ferra: Mbase banesës sociale, se tani nuk di ta them, nuk kemi gjithë banesat sociale.

Edlira Shemsi: Që s'janë dhënë banesa sociale ka 4 vjet, unë këtë e di shumë mirë. Ka patur me shumicë. E di sa banorë marrin? Janë 400 e ca, ju lutem. Janë 400 e ca që e marrin, por zonja e ka nga një rast shumë specifik, që ajo ka ardhur vetë në këto dyer që po them unë. Prandaj po vjen këtu.

Ina Ferra: Mund të aplikojë te një program tjetër strehimi. Po deshi, mund ta ndjekim bashkë.

Edlira Shemsi: Por zonja në fjalë ka takuar dhe kryetaren e bashkisë është rast shumë i njohur. Në këtë pikë të garantoj, është rast shumë i njohur.

Denisa Luarasi : Kalo tek pyetja pestë.

Ina Ferra: Zonja ka përfituar dy herë, domethënë vetëm te bursat e fëmijëve me një vlerë 43... Ajo të paraqitet tek bashkia dhe do ta ndjekim...

Edlira Shemsi: Është dokumentuar gjithçka.

Edlira Shemsi: Është pranë shkollës Naim Frashëri, pallati 901, i cili u vlerësua si DS2, ju dha nga 5 milionë lekë të vjetra banorëve. Ju tha: ...mos i bëni ndërtimet, se këtu ka problematika që nga kolona. Do të ndërhyjë bashkia për të forcuar kolonat. Nuk do futeni. Nuk janë sot e kësaj dite. Nuk i kanë lënë me ndërtu, sepse do t'i bëjë bashkia. Dhe, në fund fare, përgjigjja e fundit, para 2-3 javësh, bashkia i ka thënë: .. bashkia nuk ka fare fonde për këto. Shihni çfarë mund të bëni. Ajo që ata po bëjnë është që vazhdojnë të jenë në banesa me qera, pa asnjë lloj bonusi.

Alda Zyferi: Përshëndetje. Alda Zyferi nga Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike. Atëherë, në lidhje me pallatin, në buxhetin e vjetshëm ka qenë një fond për studim-projektim, jo vetëm për pallatin, por edhe për gjashtë pallatet e tjera, të cilat i kemi publikuar. Kemi marrë komplet pjesën e riorientimit, se si do bëhet me këto shtatë pallate, duke përfshirë edhe objektin në fjalë, tek lagjja 18. Por, pasi kemi marrë koncept-projektin e riorientimit, i jemi drejtuar Institutit të Ndërtimit, i cili ka pajisur në fund të muajit shkurt me opinionin teknik. Më pas i jemi drejtuar Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, sepse çdo projekt, siç e dini, i rindërtimit duhet ta kalojë patjetër edhe në këtë komision. Kam kontaktuar edhe javën e kaluar, që bashkë me këtë të informohemi edhe për shkollën gjimnazi "Gjergj Kastrioti", i cili presim dhe për të miratimin nga Komisioni Shtetëror i Rindërtimit. Vendimi është marrë, por do të firmoset nga të gjitha ministratë përkatëse që janë pjesë e komisionit. Më pas do të shqyrtohen mundësitë e financimit, patjetër si njësi vendore, dhe do të bëjmë të mundur me fonde që ka rindërtimi edhe nga kontratat të cilat kemi fonde që i kemi mbartur me vendimin e muajit shkurt, për t'i futur e përdorur për këto....

....zhurmë në sallë flasin njëkohësisht...

Edlira Shemsi : Do rikonstruktohet pallati....

Alda Zyferi: Këto janë procedura që nuk varen nga ne. Janë 7 pallate, të paktën tek ky pallat dhe tek një tjetër ka shumë ankesa dhe nuk kanë mundësi për t'u strehuar realisht dhe këto të shikohen me prioritet.

Edlira Shemsi: Janë pensionistë. Janë realisht njerëz që po rrinë me qira pa marrë as bonus.

Alda Zyferi: Shiko këtë drejtori kam 6 muaj që e drejtoj, shkresa i është drejtuar Institutit të Ndërtimit që në verë dhe vetëm pas insistimit ka ardhur opoenca teknike në muajin shkurt. Këto janë afate, të cilat nuk varen nga unë. Komisioni i Rindërtimit nuk varet nga unë dhe ne presim të njëjtën gjë edhe për gjimnazin "Gjergj Kastrioti". Procedurat kërkojnë afatet e veta. Të njëjtën gjë do të bëjnë edhe me kontratën që keni në zbatim, sepse folëm edhe për fondet e trashëguara. Një pjesë e këtyre fondeve janë si vijueshmëri e kontratës. Do të thotë që kontrata, nga zbatimi deri në momentin e përfundimit, ka një afat njëvjeçar dhe, patjetër, që ky fond shpërndahet në dy vite kohore. Kështu që, nëse doni të flasim në detaje për çdo pjesë, si për fondin e trashëguar ashtu edhe për zërat e rinj, unë jam e hapur t'ju pres secilën prej jush. Disa prej jush kanë ardhur, për çdo lloj problemi ju pres.

Edlira Shemsi: Duke qenë se fondet vijnë nga taksat e mbledhura të bashkisë, mund të krijoni një fond të veçantë për këta njerëz që paguajnë qiranë nga xhepi me pensionet e tyre. Gjithsesi, faleminderit juve.

Mirela Shala: Drejtoreshë, përshëndetje. Një pyetje kisha. Meqenëse u përmend gjimnazi "Gjergj Kastrioti", si do të procedohet me gjimnazin? A ka gjasa të fillojë të ndërtohet këtë vit, apo do të vazhdojë përsëri me të njëjtin ritëm?

Alda Zyferi: E di që ne jemi të parët të interesuar për ta çuar përpara këtë procedurë. Atëherë, aktualisht siç e thashë, presim miratimin nga Komisioni i Rindërtimit, pra duhet të firmoset nga ministritë përkatëse. Ka afate përkatëse, do e shikojmë. Në momentin që miratohet do vazhdojnë procedurat.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit.
Mbledhjen e deklaroj të mbyllur. Faleminderit.

Ky procesverbal mbyllet me nr. rendor 30 (tridhjetë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga kryetari i këshillit, sekretari i këshillit dhe 3(tre) këshilltarë.

Mbajtësi i procesverbalit: Loranda Cani

Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit :

Drejtuues i seancës (Zv/kryetar i Këshillit Bashkiak) :	DENISA LUARASI
Sekretar i Këshillit Bashkiak :	DORINA MILJA
Këshilltar (Zv/kryetar i Këshillit Bashkiak) :	MIRELA SHALA
Këshilltar (Kr. Grupi) :	JONUZ MYSHKETA
Këshilltar (Kr. Grupi) :	ROLANT XHELILAJ